



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 588, datë 22.7.2020

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.441,
DATË 3.6.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR
NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E HARTIMIT
TË PROJEKTEVE PËR MIRATIMIN E LEJEVE TË NDËRTIMIT,
PËR NDËRTIMIN E NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT),
NË ZONAT E SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR,
NË BASHKITË DURRËS, KAVAJË, KRUIJË, KURBIN, LEZHË,
SHIJAK DHE VORË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

- I. Në vendimin nr.441, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
 1. Titulli i vendimit ndryshohet dhe bëhet “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projekteve për miratimin e lejeve të ndërtimit, për ndërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar, në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Mirditë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak dhe Vorë”.
 2. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projektit për miratimin e lejeve të ndërtimit, përfshirë kostot për shërbime të rilevimeve topografike, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe të shërbimeve gjeologjike që i takojnë nëntokës e punimeve në themel, për ndërtimin e njërive të banimit në ndërtesa (pallat), në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar, në bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak dhe Vorë, në masën 254 159 368 (dyqind e pesëdhjetë e katër milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i kalohet fondi në masën në masën 254 159 368 (dyqind e pesëdhjetë e katër milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projekteve sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi.”.

II. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 3739/1
DATE 27-7 2020

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

